



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr. 721/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtare, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër kandidatit për kryetar të Komunës së Prishtinës Arben Vitia nga radhët e Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të shpërndarjes së materialit zgjedhor në FB, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.10.2021, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HUDHET** e palejuar ankesa Anr.721/2021 e datës 28.10.2021, Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër kandidatit për kryetar të Komunës së Prishtinës Arben Vitia nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të shpërndarjes së materialit zgjedhor në FB, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 28.10.2021 ka pranuar ankesën Anr.721/2021, paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në të cilën pretendohet se me datë 28 tetor 2021, aktivistët e LDK-së rreth orës 12:00, kanë vërejtur se kandidati për kryetar komune të Prishtinës Arben Vitia nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka shpërndarë material zgjedhor (video) 13 sekondash në të cilën bënë thirrje për votim, pa bërë specifikim e duke iu drejtuar të gjithëve pa dallim, madje në një periudhë që ende nuk janë certifikuar rezultatet duke bërë pxitje e ndërhyrje në votim. Si provë kësaj ankesë i ka bashkangjitur linkun e videos së përmendur në ankesë.

Sipas parashtresës të ankesës ky veprim bie në kundërshtim me nenin 33 pika h) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, andaj edhe përmes ankesës ka kërkuar që ndaj shkelësit të pretenduar të shqiptohet sanksioni në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

## **Ankesa është e palejuar**

Sipas Nenit 33 dhe 44 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët* dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2013 *Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike*, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ku ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Periudha për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të Komunave, e përcaktuar sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) fillon me datë 8 nëntor dhe zgjatë deri me datë 12 nëntor, andaj duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, me të cilën përcaktohen veprimet e ndaluara të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore si dhe duke pasur parasysh se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë nga pala ankuese janë zhvilluar para datës zyrtare të caktuar për fushatë zgjedhore, Paneli vlerëson se ankesa në fjalë është e palejuar ngase me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe me Rregullat Zgjedhore nuk është paraparë sanksionimi apo marrja e masave tjera ligjore për këtë periudhë të para fushatës zgjedhore.

Prandaj duke u bazuar në arsyet e lartpërmendura dhe në dispozitat e nenit 33 dhe nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr.721/2021 më datën 31.10.2021

**Kryesuesi i Panelit**  
**Burim Ademi**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.